



Agjencia e administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues
AKDIE

Adresa: Bulevardi "Bajram Curri" Pall. Agimi, shk. 14, hyrja 259
Tel : 00355 4 22 62 160 : fax : 00355 4 22 62 160
Site : www.akdie.org ; email: a.k.d.i.e.albania@gmail.com

STATUTI
"AGJENCIA E ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË DREJTAVE TË ARTISTEVE INTERPRETUES DHE/OSE
EKZEKUTUES NE "
"AKDIE"

Ne mbeshtetje te ligjit 8788 date 07.05.2001. neni 3, "Per organizatat jo fitimprurese"
Ligji nr. 8789, date 07.05.2001 "Per regjistrimin e organizatave jo fitimprurese"
Ligji 9380 date 28.04.2005, nenet 51-58 dhe neni 106 e vijues i ketij ligji, "Per te drejtat e autorit dhe te drejta te tjera te lidhura me te ", nën rezervën e cdo ndryshimi ligjor, si edhe sipas legjislacionit në fuqi, në të ardhmen për të drejtat e artistëve, hartohet ky statut:

KAPITULLI I
ADMINISTRIMI KOLEKTIV I TË TË DREJTAVE TË ARTISTËVE

NENI 1
FORMA E ORGANIZIMIT; EMËRTESA, EMRI, SIGLA DHE SIMBOLI I VEÇANTË I ORGANIZATËS;

1. "Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtës së Artistëve Interpretues dhe/ose Ekzekutues" "AKDIE" është person juridik, e themeluar fillimisht, si një organizatë jo fitimprurëse me anëtarësi, e krijuar me vullnetin e lirë të artistëve interpretues/ekzekutues, pa asnjë qëllim fitimi, jo qeveritare dhe e pavarur, e cila ushtron personalitetin juridik të saj, në një veprimtari specifike-ADMINISTRIM KOLEKTIV, sipas licensës së dhënë, sipas ligjit të kohës, sipas qëllimit të saj.
2. Emërtimi i agjencisë do të jetë "Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtës së Artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues, "AKDIE", që do të thotë "Akt-dije".
3. Agjencia do të pajiset me vulën vezake të kuqe me gërma kapitale, me të njëjtin emër inicial "AKDIE", që do të përdoret për vendimet, vërtetimet, ftesë zyrtare, shkëmbimet shkresore, etj.
4. Agjencia ka siglën e saj.
5. Vula e Agjencisë, është mjet i mjaftueshëm për të shprehur vullnetin juridik të agjencisë, së bashku me nënshkrimin e Drejtorit Ekzekutiv, për cdo akt shkresor të agjencisë, i njëjtë nga fuqia, si një vulë e noterit publik.
6. Vula disponohet nga Drejtori Ekzekutiv dhe ai është i vetmi përgjegjës në kuptim administrativ, civil ose penal, për përdorimin e saj.

NENI 2
QËLLIM DHE FUSHA E VEPRIMTARISË SË ORGANIZATËS;

Qëllimi i Agjencisë "AKDIE" është administrimi kolektiv i të drejtave të artistëve interpretues dhe/ose ekzekutues, të cilët konsiderohen në dy grupime:

- anëtarë që kanë nënshkruar aktet statutore të saj, **për qëllim të ligjit për organizatat jofitimprurëse dhe kodit civil, për shoqatat.**
- anëtarë të fushës së artit, **sipas ligjit për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të**, sipas Licensës së dhënë nga organi kompetent shtetëror,

duke arkëtuar pagesa tek subjektet përdorues të këtyre të drejtave, për shkak të përdorimit masiv të veprave artistike, të cilat shprehen dhe bazohen tek të drejtat e artistëve interpretues/ekzekutues,

dhe shpërndarjen e vlerave financiare të këtyre pagesave të mbledhura, vetëm tek ata artistë, shqiptarë ose të huaj, të drejtat e të cilëve kanë krijuar vlera monetare, në veprimtaritë tregtare të subjekteve tatimpagues, si edhe kur ato do të mund të krijonin këto vlera monetare, sipas legjislacionit në fuqi.

Çdo artist interpretues/ekzekutues shqiptar, i cili tërheq ose do të tërheq, pagesat që rrjedhin nga përdorimi i të drejtave të tij, në mënyrë masive, nga mijëra subjektet përdorues, konsiderohet automatikisht anëtar i agjencisë "AKDIE".

NENI 3

ADMINISTRIMI KOLEKTIV I TË DREJTAVE TË ARTISTËVE NË VEPRËN E INTERPRETUAR/EKZEKUTUAR.

Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Artistëve Interpretues/ekzekutues "AKDIE", **nuk administron** të drejtat individuale të artistit, të cilat çdo artist i ushtron sipas kontrateve të punës ose të porosisë tek punëdhënësi ose tek porositësi, të cilët janë persona fizikë ose juridikë, subjekte tatimpagues të ligjshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- Agjencia "AKDIE" nuk ndërhyt në marrëdhëniet e posacme artist- Punëdhënësi-Porositës, por me vendimin e Këshillit Ekzekutiv, **sipas kërkesës së shkruar të të gjithë artistëve**, të veprës si të tërë, ndërhyt me të gjitha mjetet ligjore për të garantuar vullnetin e artistëve të cënuar nga këto marrëdhënie juridike.

Agjencia e Administrimit Kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues "AKDIE" **administron** të drejtat e artistëve interpretues/ekzekutues, që rrjedhin nga përdorimi masiv i veprës artistike, si të tërë,

- **duke garantuar shpërblimin e çdo artisti**, sipas rregullave statutores dhe kontributit të tyre specifik, në veprën artistike si të tërë,
- **duke garantuar përdorimin e këtyre të drejtave nga ana e përdoruesve masiv**, kundrejt pagesës përkatëse.

Subjekt përdorues masiv janë subjektet tatimpagues, me objekt veprimtarie tregtare të përcaktuar në legjislacionin tatimor, **të cilët përdorin vepra artistike, në veprimtarinë e tyre**,

1. **përdorimi i të cilave ka ndikim themelor ose kryesor në të ardhurat e tyre**, si tatimpagues me aktivitet radio, televizione, platforma televizive dixhitale ose jo, me ose pa kabëll, satelitore, tokësore, analoge, valore, ofruet të përmbajtjeve të veprave artistike në internet, në valët e telefonisë së lëvizshme, etj, sipas teknologjisë aktuale ose të ardhshme.
2. **ose ndikim dytësor ose ndihmës, në të ardhurat e tyre**, si tatimpagues me aktivitet bar, restorant, hotel, motel, fshatra turistik, qendra tregtare, e të ngjashme me këto kategori, sipas veprimtarive tregtare, të njohura nga legjislacioni tatimor.

Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Artistëve Interpretues/Ekzekutues "AKDIE" **përfaqëson ligjërisht të drejtat e artistëve interpretues/ekzekutues**, në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe sipas Kontratave të Përfaqësimit Reciprok, jashtë këtij territori.

Agjencia "AKDIE" gëzon legjitimitet aktiv dhe është në pozitën e të dëmtuarit,

1. për shkak të licensës së dhënë nga organi kompetent, për veprimtarinë e administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues, **si një akt shkresor zyrtar i Ministrit përgjegjës, i shprehur shprehimisht nga ligji, për administrim degë apo fushë arti.**
2. për shkak të këtij statuti, për anëtarët themelues dhe kontribues të saj,
3. për shkak të kontributit të dhënë, nga secili artist i saj, në një vepër artistike, së bashku me artistët e tjerë.
4. për shkak të personalitetit të saj juridik të mëvetsishëm nga e drejta individuale e artistëve.

NENI 4

TË DREJTAT E ADMINISTRUESHME NGA AGJENCIA "AKDIE"

Agjencia e Administrimit Kolektiv ka të drejtë dhe administron vetëm ato të drejta, të cilat nuk mund të ushtrohen, nuk mund të mbrohen dhe nuk mund të përfaqësohen, në mënyrë të mëvetsishme nga njeriu artist,

konsideruar veprën si të tërë dhe kontributin e tij në vepër, të lidhur pazgjidhshmërisht dhe të shkrirë, në mënyrë të padallueshme, në veprën artistike si të tërë, duke garantuar qarkullimin masiv, të lirë dhe të ligjshëm të veprës artistike, **konsideruar numrin, shtrirjen territoriale të mijëra-mijërave subjekteve përdorues**, brenda dhe jashtë Shqipërisë, ku përdoret vepra artistike si e tërë.

Agjencia "AKDIE", administron, ushtron dhe përfaqëson juridikisht, në formë të ligjshme, sipas legjislacionit në fuqi, në territorin e Shqipërisë, sipas legjislacionit evropian dhe normave ndërkombëtare, ku Republika e Shqipërisë është anëtare, **SI TITULLARE E VETME E LIGJSHME, grupimet e mëdha të administrimit kolektiv të të drejtave :**

1. E drejta për shpërblimin e drejtë të interpretuesve/ekzekutuesve, që ruhet pas kalimit të të drejtave të tyre ekskluzive të qiradhënies të prodhuesit e fonogrameve ose i veprave audiovizuale.
2. E drejta e interpretuesve/ekzekutuesve për një shpërblim të drejtë, për transmetimin dhe përcjelljen në publik të fonogrameve të publikuara për qëllime tregtare, sipas ligjit, me prodhuesin fonografik.
3. E drejta e ritransmetimit kabllor të veprave dhe transmetimit satelitor
4. E drejta e regjistrimit të veprave muzikore në fonogram, në ato raste kur autorët kanë autorizuar tashmë prodhuesin e fonogramit për këtë regjistrim;
5. E drejta e interpretuesve/ekzekutuesve që vënë në dispozicion të publikut në mënyrë ndërvepruese interpretimet/ekzekutimet e tyre të fiksuara në fonogram.
6. e drejta për shpërblimin e drejtë për kopjimin privat të veprave dhe objekteve të të drejtave të lidhura,

me të gjitha format që njeh dhe do të njoh teknologjia.

NENI 5 ANËTARËSIA

Agjencia "AKDIE", **marr në konsideratë :**

1. Pjesëmarrjen e saj në organizatat ndërkombëtare, të administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve, duke qënë pjesë e këtij sistemi, zbaton parimin ndërkombëtar:

Përdorimi i të drejtave të artistëve sjellë pasoja pozitive ekonomike për përdoruesit masiv të të drejtave dhe pagesa i jepet vetëm artistit, shqiptar ose të huaj, përdorimi specifik i të drejtës të tij, në veprën artistike, e cila është përdorur/komunikuar ose janë vendosur në dispozicion të publikut, në mënyrë ndërvepruese, gjatë vitit kalendarik, ka ndikuar në mënyrë financiare, tek subjektet tatimpagues, përdorues të këtyre të drejtave.

2. Ligjin për organizatat jofitimprurëse, si dhe dispozitat e Kodit Civil, për shoqatat:

Agjencia "AKDIE" njeh dhe pranon si antarë të saj, këto grupime artistësh:

1. Aktorët
2. Kënetarët
3. Muzikantët
4. Valltarët
5. Drejtues orkestre
6. Drejtues kori
7. Personat që luajnë një rol mbështetës, por të rëndësishëm;
8. Prezantuesit
9. Recituesit
10. Spikerat

Sipas këtyrë përkufizimeve:

1. Artist Anëtar i agjencisë "AKDIE" është dhe do të konsiderohet çdo person artist, shtetas shqiptar, i cili ka interpretuar/ekzekutuar në një vepër artistike, të çdo lloj zhanri artistik, **vepër e cila i është përcjellë publikut ose është vendosur në dispozicion publikut**, në mënyrë ndërvepruese, më të gjitha format që njeh ose do të njoh teknologjia, në mënyrë masive, **gjatë vitit kalendarik** të mëparshëm dhe si akt pranimi i statutit të AKDIE-s, konsiderohet pagesa e marrë ose që do të marrë, në numrin e llogarisë së tij bankare, brenda afatit 3 vjeçar, kur shuhet e drejta e kërkimit gjyqësor, sipas afatit parashkrimit të padisë, nga viti kalendarik kur është përdorur interpretim/ekzekutimi i tij, në veprën artistike,

Sipas skemës së Mbledhjes së Pagesave, sipas përdorimit të të drejtave të artistëve, sipas veprave të përdorura gjatë minutazhit të vitit kalendarik=525 600 minuta:

Agjencia AKDIE ka detyrimin e arktëtimit të pagesave për 365 ditë të vitit kalendarik, që do të thotë :

365 ditëX 24 orë X 60 minuta = 525 600 minuta.

- A. një vepër muzikore ka 3 minuta
- B. një vepër audiovizuale ka 30-120 minuta
- C. një vepër kinematografike ka 120 minuta.

Në vit, matematikisht, përdoren :

- 175 200 vepra muzikore- (1 këngëtar-3 korrista-6 instrumentista)= **1 750 000** artistë shqiptarë dhe të huaj.
- 4380 filma- (1-aktor kryesor, 10 aktorë dytësor, 1 këngëtar-3 korrista-6 instrumentista) 20 artistë= **87 600 artistë** shqiptarë dhe të huaj
- 17520 lajme, spektakël, etj

2. Artist Anëtar i agjencisë “AKDIE” është dhe do të konsiderohet çdo person artist -shtetas I huaj, i cili kërkon me akt të shkruar, i shoqëruar me dokumentacionin e duhur, se dëshiron të jetë anëtar i Agjencisë AKDIE dhe pranohet si i tillë, me Vendim të Këshillit Ekzekutiv dhe Asamblesë së Përgjithshme, vetëm pasi të ketë provuar me aktet shkresore, të njohura si të tilla nga legjislacioni ndërkombëtar, se nuk është anëtar i asnjë agjencie tjetër, të vendit të origjinës së tij ose se ka tërhequr të drejtat e tij, nga administrimi i asaj agjencie dhe nuk ka asnjë problem ligjor me atë agjenci.

3. Artist Anëtar i Agjencisë “AKDIE” është dhe do të konsiderohet çdo artist shqiptar, i cili ka interpretuar/ekzekutuar në një vepër artistike, të cdo lloj zhanri artistik, **vepër e cila i është përcjellë publikut ose është vendosur në dispozicion publikut**, në mënyrë ndërvepruese, në mënyrë masive, **brënda afatit ligjor të mbrojtjes së të drejtës së artistit** dhe si akt pranimi I statutit të AKDIE-s, konsiderohet Vendimi i Këshillit Ekzekutiv dhe Vendimi i Asamblesë së Artistëve.

4. Artist Anëtar i Agjencisë “AKDIE” është dhe do të konsiderohen anëtarët themelues dhe kontribues të Agjencisë “AKDIE”, **sipas ligjit për organizatat jofitimprurëse dhe Kodit Civil, për shoqatat**, të cilët përfaqësojnë dhe janë vullneti i shprehur i komunitetit të artistëve, sipas kategorive dhe përkufizimeve më sipër, **si dhe janë ata që prodhojnë, zgjedhin dhe zgjidhen në organet drejtuese vendimarrëse të Agjencisë.**

Neni 5/1.

THEMELUESIT DHE ANËTARËT KONTRIBUES.

Agjencia “**Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtës së Artistëve Interpretues dhe/ose Ekzekutues në Fushën e Audiovizualit “AKDIE”** është themeluar nga anëtarët e saj si me poshtë:

1. **Tefta Radi**, e bija e Çerçizit e datëlindjes 19.01.1952, lindur në Gjirokastrë, banuese në Tiranë, Rr. „Sami Frashëri”, pall. 15, ap.30, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaportë nr.Z0895368, me cilësinë e prezantueses.
2. **Arben Duro**, me kombësi Shqiptare dhe me shtetësi Austriake, i biri i Xhaferrit, i datëlindjes 12.07.1959, lindur dhe banues në Tiranë, Rr. “Hoxha Tasim”, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaportë me nr.J021584, me cilësinë e këngëtarit.
3. **Robert Ndrenika**, i biri i Petros, i datëlindjes 10.01.1942, lindur dhe banues në Tiranë, Rr.”M.Shyri”, pall.126, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me letërnjoftimi E V ne.200536, me cilësinë e aktorit.

4. **Vasillaq Vangjeli**, i biri i Nikollaqit, i datëlindjes 19.02.1948, lindur në Peshkopi, banues në Tiranë Rr. "5 Maji", pall.nr.3, ap.45, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaportë me nr. Z0751402, me cilësinë e aktorit.
5. **Liljana Kondakci**, e bija e Llambit, e datëlindjes 12.10.1953, lindur dhe banuese në Tiranë, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaportë nr. Z1687820, me cilësinë e këngëtarit.
6. **Alqi Kareco**, i biri i Lames, i datëlindjes 10.07.1932, lindur dhe banues në Tiranë, Rr."Tefta Tashko", nr.102, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaportë nr.Z 0602578, me cilësinë e dirigjentit.
7. **Rexhep Çeliku**, i biri i Mehdiut, i datëlindjes 10.07.1954, lindur dhe banues në Tiranë,Rr. "Shinasi Deshnica", pall. i firmës Unikon, shk.A, ap. 8/4, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaportë nr. Z 0679122, me cilësinë e valltarit.
8. **Anita Tartari**, e bija e Mimetit, e datëlindjes 27.07.1945, lindur dhe banues në Tiranë, Rr. „Kavajës“, pall. 155/94, shk.1, ap.3, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me pasaportë nr. Z 0785679, me cilësinë e instrumentistes.

a. Anëtarë kontribues, të cilët janë shtuar gjatë viteve, si anëtarë statutor janë :

9. Ndriçim Xhepa
10. Ardian Trebicka
11. Jani Çekishi
12. Denis Skura,
13. Fatos Bardulla,
14. Sokol Idërshaj
15. Agron Bulku,
16. Afrim Kica
17. Julian Gjojdeshi
18. Aranit Hoxha
19. Klodian Kaçani
20. Arben Bilali
21. Zaim Hasrama
22. Zhani PETROPULLOS (ZICISHTI)
23. Mark TOPALLAJ,
24. Gjergj TOPALLAJ
25. Domenika NDRECA,
26. Lorena ISAKU,

NENI 6

TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ANËTARËVE NDAJ AGJENCISË

Cdo artist interpretues dhe / ose ekzekutues, i cili është anëtar themelues ose kontribues, i agjencisë „AKDIE“, është i detyruar :

1. Të respektojë dhe të veprojë në përputhje me Statutin e Agjencisë, për të cilin ai deklaron se e njeh dhe e respekton atë.
2. Të mos bëjë asnjë marrëveshje në kundërshtim me ligjin, në formë individuale, në dëm të interesave të Agjencisë.
3. Të marrë pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Artistëve dhe kur është i zgjedhur, edhe në Këshillin Ekzekutiv, duke respektuar rregullat statutorë.
4. Mosmarrja pjesë, për më shumë se 3 herë rradhazi, në Asamblenë e Përgjithshme ose, kur është i zgjedhur, në Këshillin Ekzekutiv, pa arsye të ligjshme, i jep të drejtën Këshillit Ekzekutiv, për t'ia hequr artistit, të drejtën e përfitimit nga „FONDI I NDERIT“.
5. Të depozitoj në Regjistrin Elektronik dhe të shkruar të Agjencisë, veprat artistike, ku ai ka kontribuar, si artist, me interpretimet dhe ekzekutimet e tij.
6. T'i nënshtrohet, në bazë të Statutit dhe Rregullores së Përgjithshme, vendimeve të Këshillit Ekzekutiv;
7. Çdo anëtar është i detyruar, me kërkesë të agjencisë, të paraqesë çdo dokument që provon kontributin e tij, si artist, në një vepër të caktuar artistike.
8. Në një mënyrë të përgjithshme të mos bëjë asgjë dhe të mos ndërmarrë asnjë veprim që të çenojë interesat pasurore dhe jopasurore të Agjencisë dhe anëtarëve të saj.

9. Çdo artist, anëtar i agjencisë "AKDIE" ushtron të drejtën e tij, për të qënë anëtar kontribues i Agjencisë, me nënshkrimin e Aktit të Pranimit të Statutit, ose "AKT-DIJENINË".
10. Çdo artist, ka të drejtën e ligjshme të largohet nga agjencia "AKDIE", sipas kërkesës së tij me shkrim, drejtuar Drejtorit Ekzekutiv, i cili e paraqet këtë kërkesë për miratim në Këshillin Ekzekutiv, në mbledhjen më të afërt, vendimmarrja e Këshillit miratohet nga Asambleja e Përgjithshme, në mbledhjen më të afërt.
11. Në rast se kjo kërkesë është urgjent, për shkak se artisti nuk dëshiron të jetë anëtar i "AKDIE" ose sepse ka gjetur një mbrojtje efektive më të mirë, për të drejtat e tij, por pa cënuar në asnjë rast të drejtat e artistëve të tjerë, pjesëmarrës në veprat e tij artistike, Drejtori Ekzekutiv, miraton këtë kërkesë me shkrim, nën përgjegjësinë e tij, duke zbatuar me përpikmëri procedurën e mësipërme.
12. Çdo artist themelues ose kontribues, mund të përjashtohet nga Agjencia "AKDIE", sipas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Artistëve, sipas propozimit të Këshillit Ekzekutiv ose të artistëve pjesëmarrës në një vepër artistike të përbashkët me artistin, i cili përjashtohet, për këto shkaqe:
 - Fyen, shpif ose dëmton me dashje grupin e artistëve, të drejtat e artistëve ose agjencinë "AKDIE".
 - Përfshihet me dashje në veprime të kundraligjshme, për të dëmtuar agjencinë "AKDIE".
 - Nuk zbaton me ndershmëri, përpikmëri dhe seriozitet Vendimet e Këshillit Ekzekutiv ose të Asamblesë së Përgjithshme.
 - Aktet e përjashtimit, i nënshtrohen procedurës gjyqësore, sipas kërkesës së të interesuarit dhe agjencia zbaton në mënyrë vullnetare, vendimin e formës së prerë të gjykatës.

NENI 7

ADMINISTRIMI FINANCIAR I ADMINISTRIMIT KOLEKTIV TË TË DREJTAVE METODA E SHPËRNDARJES

Agjencia AKDIE ka detyrimin e arktëtimit të pagesave për 365 ditë të vitit kalendarik, që do të thotë :

365 ditë X 24 orë X 60 minuta = 525 600 minuta.

- D. një vepër muzikore ka 3 minuta
- E. një vepër audiovizuale ka 30-120 minuta
- F. një vepër kinematografike ka 120 minuta.

Në vit, matematikisht, përdoren :

- 175 200 vepra muzikore- (1 këngëtar-3 korrlista-6 instrumentista)= **1 750 000** artistë shqiptarë dhe të huaj.
- 4380 filma- (1-aktor kryesor, 10 aktorë dytësor, 1 këngëtar-3 korrlista-6 instrumentista) 20 artistë= **87 600 artistë** shqiptarë dhe të huaj
- 17520 lajme, spektakël, etj

MUZIKA

➤ vepra muzikore, të hedhura në mbajtëse vetëm zëri (Kasetë audio-CD)

Artisti interpretues-Këngëtar-Solist

Artistët intepretues-këngatar Korri.

Artistët ekzekutues-instrumentistët-orkestra, sipas veglave muzikore.

Vlera e veprës e ndarë në përqindje, ndahet rregullisht sipas kontratës së punës ose porosisë,

NË RAST SE NUK KANË SAKTËSUAR KËTO ELEMENT, ME ANË TË KONTRATËS, NDAHET SI VIJON :

- | | |
|--|---------|
| 1. Solisti | 25%-35% |
| 2. Korrlistët | 25%-15% |
| 3. Instrumentisti i parë | 15%-20% |
| 4. Instrumentitët e veglave mbështetëse- | 35%-30% |

➤ vepra muzikore, të hedhura në mbajtëse zëri dhe figure - vepra muzikore audiovizuale-(Kasetë video-DVD)

1. Artisti interpretues-Këngëtar-Solist
2. Aktor kryesor
3. Artistët interpretues-këngëtar Korri
4. Aktorë dytësor
5. Artistët ekzekutues-instrumentistët-orkestra, sipas veglave muzikore.

Vlera e veprës e ndarë në përqindje, ndahet rregullisht sipas kontratës së punës ose porosisë,

Në rast se nuk kanë saktësuar këto elementë, me anë të kontratës, ndahet si vijon :

- | | | |
|---|-----------------------|-----|
| 1. Solisti | aktor kryesor | 40% |
| 2. Korristët | aktorë dytësor | 20% |
| 3. Instrumentisti i parë, | pjesëmarrës si aktor | 20% |
| 4. Instrumentitëst e veglave mbështetëse- | pjesëmarrës si aktorë | 20% |

➤ Kur vepra muzikore ndahet nga vepra audiovizuale,

Vlera e veprës e ndarë në përqindje, ndahet rregullisht sipas kontratës së punës ose porosisë,

Në rast se nuk kanë saktësuar këto elementë, me anë të kontratës, ndahet si vijon :

- | | |
|--|-----|
| 1. Solisti | 25% |
| 2. Korristët | 10% |
| 3. Instrumentisti i parë, | 10% |
| 4. Instrumentitëst e veglave mbështetëse | 10% |
| 5. Aktor kryesor | 25% |
| 6. Aktorë dytësor | 20% |

FILMI-AUDIOVIZUALI

Vlera e veprës e ndarë në përqindje, ndahet rregullisht sipas kontratës së punës ose porosisë,

NË RAST SE NUK KANË SAKTËSUAR KËTO ELEMENT, ME ANË TË KONTRATËS, NDAHET SI VIJON :

➤ Vepra audiovizuale kinematografike

❖ Artisti interpretues/ekzekutues (MUZIKA) 30%

Kjo përqindje ndahet, si vlerë totale, si vijon:

- | | | |
|------|--|---------|
| i. | Solisti | 25%-35% |
| ii. | Korristët | 25%-15% |
| iii. | Instrumentisti i parë | 15%-20% |
| iv. | Instrumentitëst e veglave mbështetëse- | 35%-30% |

❖ Aktor/aktorët kryesor 40%

❖ Aktorët dytësor(sipas rolit dhe përqindjes së kohës së luajtur) 30%

➤ Vepra audiovizuale televizive

Vlera e veprës e ndarë në përqindje, ndahet rregullisht sipas kontratës së punës ose porosisë,

NË RAST SE NUK KANË SAKTËSUAR KËTO ELEMENT, ME ANË TË KONTRATËS, NDAHET SI VIJON :

❖ Artisti interpretues/ekzekutues (MUZIKA-KOLONË ZANORE) 40%

Kjo përqindje ndahet, si vlerë totale, si vijon:

- | | |
|---|---------|
| 1. Solisti | 25%-35% |
| 2. Korristët | 25%-15% |
| 3. Instrumentisti i parë | 15%-20% |
| 4. Instrumentitëst e veglave mbështetëse- | 35%-30% |

❖ Drejtuesi (spikeri)/drejtuesit e veprës audiovizuale 30%

❖ Grupi koreografik (në rast se ka) 30%

Kjo përqindje ndahet, si vlerë totale, si vijon:

- | | |
|-------------------------|---------|
| i. Balerin i parë | 35%-50% |
| ii. Balerinë mbështetës | 65%-50% |

NENI 8

KOHËZGJATJA

Afati i veprimtarisë së agjencisë është i papërcaktuar.

KAPITULLI II

ORGANET DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

NENI 9

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

1. Organi më i lartë drejtues vendimmarrës i agjencisë është Mbledhja e Përgjithshme e Anëtareve themelues dhe kontribues të Agjencisë AKDIE, e cila mblidhet, në selinë e Agjencisë "AKDIE", sipas Kërkesës së Presidentit të Agjencisë AKDIE, bazuar në Vendimin e Këshillit Ekzekutiv, brenda kohës së caktuar për miratimin e veprimtarisë financiare të Agjencisë dhe shpërndarjes së vlerave monetare tek artistët, por në cdo rast jo më pak se një herë në vit.
2. Organi më i lartë vendimmarrës nuk mund të ketë më pak se 5 anëtare dhe mblidhet me pjesëmarrjen e 5 anëtarëve të tij dhe vendos, me shumicën e anëtarëve të pranishëm.
3. Çdo anëtar themelues ose kontribues, ka të drejtën e një vote të vetme dhe të barabartë me të tjerët, në Asamble të Përgjithshme.
4. Votimi zakonisht, kryhet i hapur, por sipas rëndësisë së çështjeve, Asambleja e Përgjithshme mund të votojë edhe me votim të fshehtë, për çështje, objekti i të cilave, kërkohet të mos bëhet i njohur vullneti i artistëve.
5. Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme e anëtarëve themelues dhe kontribues, mund të mblidhet, për çështje urgjente, sipas kërkesës së 1/5 së anëtarëve themelues dhe/ose kontribues, sipas kërkesës së një anëtari të Këshillit Ekzekutiv, sipas Vendimit të Këshillit Ekzekutiv ose sipas kërkesës së Presidentit ose të Presidentit të Nderit, për këto shkaqe:
 - për shkak të ndryshimeve ligjore, të cilat duhet të reflektohen në Statut,
 - për shkak të çështjeve urgjente, që kanë të bëjnë me cenimin e të drejtave të artistëve ose të agjencisë, nga ndonjë vendim administrativ, gjyqësor,
 - për shkak të çështjeve urgjente, që kanë të bëjnë me marrëdhëniet ndërkombëtare, ku agjencia "AKDIE" është palë, si dhe për cdo situatë tjetër, që Këshilli Ekzekutiv, e kosnideron të domosdoshme vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme dhe se nuk pret koha deri në mblledhjen e saj, në kohën e saj të natyrshme.

NENI 10

KOMPETENCAT E ASAMBLESE SË PËRPGJITHSHME TË ANËTARËVE THEMELUES DHE KONTRIBUES

Organi më i lartë Drejtues është Asambleja e Artistëve themelues dhe kontribues dhe ky është organi më i lartë vendimmarrës i Agjencisë "AKDIE", i cili përveç çështjeve të tjera që çmon se duhet të shqyrtohen prej tij,

1. Zgjedh Presidentin e Asamblesë së Artistëve themelues, kontribues dhe të Artistëve në territorin e Republikës së Shqipërisë, për administrimin kolektiv të të drejtave të tyre, për një afat 5 vjeçar, më të drejtë rizgjedhjeje, në këtë post.
2. Presidenti i Agjencisë është edhe Presidenti i Këshillit Ekzekutiv.
3. Zgjedh anëtarët e Këshillit Ekzekutiv, sipas zhanreve artistike, sipas grupimeve të artistëve.
4. Vendos për ndryshimin e statutit,
5. Përcakton fushat dhe programet e veprimtarisë,
6. Mbikëqyr dhe kontrollon rregullisht realizimin e tyre,
7. Shqyrton çështjet ekonomike, financiare dhe të administrimit të agjencisë “AKDIE”
8. Miraton aktet më të rëndësishme në lidhje me buxhetin e organizatës jofitimprurëse dhe shpenzimet për vitin e ardhshëm,
9. Nxjerr norma për rregullimin e veprimtarisë, të organizimit dhe të strukturës së organizatës,
10. Krijon komitete të posaçme, si dhe vendos edhe për çështje të tjera të parashikuara shprehimisht në ligj ose në statut.
11. Anëtarët e organit më të lartë vendimmarrës, si rregull, ushtrojnë funksionin e tyre pa shpërblim.
12. Për shpërblimin e artistëve interpretues/ekzekutues, në respektim të parimit të interesit më të mirë të organizatës, në varësi të kushteve të saj, të numrit dhe të kohëzgjatjes së mbledhjeve, mund të rimbursojë shpenzimet dhe të shpërblejë në mënyrë të arsyeshme anëtarët e organit më të lartë drejtues për pjesëmarrjen në mbledhjet e tij, duke themeluar fondin e nderit.
13. Ata shpërblehen edhe në rastet kur përmbushin detyra të caktuara.

NENI 10 FONDI I NDERIT

Agjencia disponon Fondi e Nderit të Anëtarëve themelues dhe kontribues, në vlerën 10% të të ardhurave të mbledhura në total, pasi të jenë hequr detyrimet e legjislacionit tatimor, për të mundësuar “SHPËRBLIM PËR ANËTARËT AKTIV KONTRIBUES TË AGJENCISË”, duke i dhënë autorizimin Drejtorit Ekzekutiv, për të kryer shpërblime të barabarta për ta, vetëm në ato raste, kur për ata nuk janë mbledhur pagesa nga subjektet PËRDORUES”.

NENI 11 RREGULLAT PËR MBAJTJEN E MBLEDHJES SË PËRGJITHSHME TË ANËTARËVE (pjesëmarrja)

Organi më i lartë vendimmarrës i organizatës jo fitimprurëse me anetarësi, që është Mbledhja e Përgjithshme e anëtarëve, nuk mund të ketë më pak se pesë anëtarë. Organi më i lartë vendimmarrës mblidhet me pjesëmarrjen e më shumë se gjysmës së anëtarëve të tij dhe vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm, me përjashtim të rasteve të përcaktuara në statut.

NENI 12 MËNYRA DHE PROÇEDURA E VOTIMIT PËR MARRJEN E VENDIMEVE

Mbledhja e përgjithshme, për marrjen e vendimeve, vendos me shumicën e anëtarëve të pranishëm. Gjithashtu ajo mblidhet brenda kohës së caktuar për zhvillimin e tyre, por në çdo rast jo më pak se një herë në vit.

NENI 13 MËNYRA E MIRATIMIT TË NDRYSHIMIT TË STATUTIT, TË AKTIT TË THEMELIMIT DHE RREGULLAVE TË BRENDSHME

Ndryshimi i Statutit të Agjencisë bëhet nga mbledhja e përgjithshme e anëtarëve të saj. Në rast se statuti nuk parashikon një shumicë votash, ndryshimet në statut bëhen me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të Agjencisë.

NENI 14 PRESIDENTI I AGJENCISË

Presidenti i Agjencisë është **Z. Jani ÇEKIXHI**, i cili ka këto kompetenca:

1. Drejton mbledhjen e përgjithshme.

2. Presidenti i Agjencisë AKDIE, ka kompetencë të thërras mbledhjen e përgjithshme të anëtarëve themelues dhe kontribues, në tre mujorin e parë dhe të fundit, në varësi të veprimtarisë së agjencisë.
3. Presidenti i Agjencisë është kryetari që drejton Mbledhjen e përgjithshme.
4. Presidenti i Agjencisë është kryetari që drejton Këshillin Ekzekutiv.
5. Presidenti është figura përfaqësuese e Agjencisë AKDIE, për nivelet më të larta të përfaqësimit të institucioneve homologe dhe shtetërore, duke vepruar sipas raportit protokollar.
6. Presidenti mund të shkarkohet vetëm nga Asambleja e Përgjithshme e artistëve, sipas propozimit të Këshillit Ekzekutiv, me 2/3 e votave të fshehta të anëtarëve të pranishëm në atë mbledhje, kur Presidenti i agjencisë ka kryer :
 - shkelje të rëndë të Statutit
 - i është hequr liria, për shkak të një vendimi gjyqësor penal
 - është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi penal.
- 1.** Propozimi për shkarkimin e Presidentit në këto raste, mund të bëhet edhe nga jo më pak se një e katërta e anëtarëve të mbledhjes së përgjithshme dhe duhet të mbështetet nga jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij.
- 2.** Vendimi i mbledhjes së përgjithshme i dërgohet Gjykatës kompetente, sipas palëve të interesuara në rastin konflikt, duke u deklaruar me turp shkarkimin e tij nga detyra.

ENI 15

PRESIDENTI I NDERIT DHE SENATORËT E PËRJETSHËM

Presidenti i Nderit të Agjencisë “AKDIE” është **Z. Robert NDRENIKA**.

Ai ka kompetencë të thërras mbledhjen e përgjithshme të anëtarëve , kur krijohet konflikt midis Drejtorit Ekzekutiv dhe Presidentit të Këshillit Ekzekutiv.

- Presidenti i nderit të Agjencisë është kryetari që drejton Mbledhjen e përgjithshme të jashtëzakonshme, për këtë rast.

Senatori i Përvjetshëm i Agjencisë “AKDIE” është **Z. Vasillaq VANGJELI**.

Pas vdekjes, **Presidenti në detyrë** ose **Presidenti i Nderit**, merr pozitën statutore të **Senatorit të Përvjetshëm**, cilësi e cila ushtrohet nga trashëgimtarët e të ndjerit, brenda periudhës ligjore të kohëzgjatjes së mbrojtjes së të drejtës së artistit, duke barazuar vendimmarrjen e asaj pozite, me atë të Presidentit të Nderit, për shkaqe të përligjura.

- Kjo pozitë vlen deri në kalimin e afatit të mbrojtjes së të drejtës së artistit.
- Në rast të një mosdakordësie midis Presidentit të Nderit dhe Presidentit në fuqi apo Këshillit Ekzekutiv, vota e Senatorit të Përvjetshëm, përcakton vendimmarrjen.
- Në rast të mungesës së tij, presidenti i agjencisë, ose kur ka konflikt midis Drejtorit Ekzekutiv dhe Presidentit të Këshillit Ekzekutiv, kjo Mbledhje e Jashtëzakonshme drejtohet nga anëtari më i moshuar i Këshillit Ekzekutiv.
- Presidenti i Nderit mund të largohet nga posti vetëm me kërkesën e tij

ENI 16

ORGANI DREJTUES- KËSHILLI EKZEKUTIV

- 1.** Agjencia, për nga pikëpamja ekzekutive, drejtohet nje organ ekzekutiv qe quhet Keshilli Ekzekutiv, I cili zgjedh Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë.
- 2.** Këshilli Ekzekutiv I Agjencisë, zgjidhet në çdo 5 vjet, me votim të hapur ose të fshehtë, nga Asambleja e Përgjithshme e Artistëve themelues dhe kontribues, ose Mbledhja e Madhe e Artistëve, sipas rendit të ditës, të votuar në atë asamble.
- 3.** Anëtarët e Këshillit Ekzekutiv zgjidhen nga Asambleja e Artistëve Themelues dhe Kontribues, sipas zhanreve artistik dhe qëndrojnë në këtë pozitë për jo më pak se 5 vjetë, duke gëzuar të drejtën e qëndrimit edhe për mandatin pasardhës, pakufizim, sipas votëbesimit të Asamblesë së Përgjithshme.
- 4.** Cdo anëtar i Këshillit Ekzekutiv, gëzon të gjitha të drejtat e një anëtari themelues dhe kontribues, duke gëzuar kështu të drejtën që të largohet nga Këshilli Ekzekutiv, me dëshirën dhe kërkesën e tij.
- 5.** Këshilli Ekzekutiv ka të drejtë të përjashtojë një anëtar të Këshillit Ekzekutiv nga Këshilli dhe ta zëvendësoj atë anëtar, më një tjetër anëtar nga Asambleja e Përgjithshme, por gjithmonë, duke

ruajtur, përfaqësimin në Këshill të zhanrit artistik, për shkak të mospjesëmarrjes, për më shumë se 3 (tre) herë në mbledhjen e Këshillit Ekzekutiv.

6. Këshilli Ekzekutiv mund të mbledhet, në selinë e Agjencisë 4 (katër) herë në vit, cdo 3 (tre) muaj, duke e përcaktuar Presidenti i Këshillit Ekzekutiv, ditën, orën dhe rendin e ditës, sipas kërkesës së Drejtorit Ekzekutiv, por në asnjë rast më pak se 2 (dy) herë në vit, përpara përpilimit të akteve shkresore përfundimtare të Agjencisë, për veprimtarinë financiare të vitit kalendarik dhe të mbylljes së bilancit vjetor për llogari të organit tatimor.

7. Anëtarët e Këshillit Ekzekutiv shpërblehen për cdo Mbledhje, me një vlerë prej 10 000 lekë, nga “FONDI I NDERIT”

8. Këshilli Ekzekutiv perbehet prej 5 vetëve, të cilët janë:

1. Jani Çekixhi
2. Ndrëçim Xhepa
3. Rexhep Çeliku
4. Aranit Hoxha
5. Gramoz Burba

- Presidenti i Këshillit Ekzekutiv të agjencisë është **Z. JANI ÇEKIXHI.**

1. Këshilli Ekzekutiv i agjencise, zgjedh Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë, i cili është organi më i lartë ekzekutiv dhe Sekretariatit e Këshillit Ekzekutiv.

- Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë AKDIE është **Z. NAIM ALIAJ**
- Sekretariati i Agjencisë zgjidhet, nga Presidenti i Agjencisë, tek administrate teknike e Agjencisë dhe mban proces-verbalin e Mbledhjeve të Këshillit Ekzekutiv dhe të Asamblesë së Përgjithshme.
- Sekretariati shpërblehet, për cdo mbledhje të Këshillit Ekzekutiv ose të Asamblesë së Përgjithshme, me një vlerë prej 2 000 lekë, për mbledhje.

2. Vendimet merren me shumicën e thjeshtë të votave të pranishme në mbledhje. Në rast se votat janë të barabarta, vota e Presidentit të agjencisë është vendimtare në marrjen e vendimeve.

NENI 17

KOMPETENCAT E KËSHILLIT EKZEKUTIV

Këshilli Ekzekutiv i agjencisë ka këto kompetenca:

- 1.** Përgatit projekt-programin vjetor të aktiviteteve dhe i'a paraqet për miratim mbledhjes së përgjithshme.
- 2.** Aprovon raportin vjetor të realizimit të detyrave të agjencisë.
- 3.** Cakton mënyrën e realizimit të të ardhurave të agjencisë.
- 4.** Vendos për ndryshimet që duhen bërë në rregullimet e agjencisë.
- 5.** Merr në shqyrtim dhe vendos për propozimet që bëhen nga institucione publike ose private, për administrimin kolektiv të të drejtave, si dhe organizata të ndryshme me qëllim bashkëpunimi e ndihme të ndërsjelltë.
- 6.** Diskuton çdo gjë të jashtëzakonshme që vihet në rendin e ditës të mbledhjes dhe merr vendime rreth tij.
- 7.** Vendos për politikën e drejtimit të agjencisë.
- 8.** Vepron si një gjykatë pajtimi për artistët.

- 9.** Ne rast se konflikti, nuk zgjidhet me pajtim, konflikti i relatohet Mbledhjes së Përgjithshme të Jashtëzakonshme, e cila është organi vendimmarrës.
- 10.** Kontrollon mënyrën e mbledhjes së parave, futjen në arkë dhe shpërndarjen e tyre tek artistët, sipas normave statutore dhe ndërkombëtare.
- 11.** Këshilli Ekzekutiv mund t'i japë të drejtë komisionerëve të kontrollojnë buletinet e deklaratave dhe të vendos klasifikimin e çdo vepre duke aplikuar tabelat e llogaritjeve.
- 12.** Vendimet që merren nga komisionet i nënshtrohen ratifikimit nga Këshilli Ekzekutiv.
- 13.** Këshilli Ekzekutiv disponon të gjitha fondet sociale, rregullon vendosjen apo zhvendosjen e tyre dhe përdorimin.
- 14.** Këshilli Ekzekutiv vendos për të gjitha blerjet apo qiratë.
- 15.** Këshilli Ekzekutiv pranon ose refuzon subvencionet, donacionet dhe dhuratat që i bëhen agjencisë.
- 16.** Këshilli Ekzekutiv shprehet mbi pranimin e artistëve, në cilësi të anëtarëve të agjencisë kontribues dhe cdo vit, të paktën dy muaj përpara se të mbledhet Asambleja e Përgjithshme, ai i ndan ata, sipas shkallëve të përcaktuara në grupimet përkatëse të të drejtave.
- 17.** Vendimet që merren nga Këshilli Ekzekutiv, brenda kufijve të atribuave të tij, janë të detyrueshme për të gjithë anëtarët e Akdies.
- 18.** Këshilli Ekzekutiv në momentin e zgjedhjes së Drejtorit Ekzekutiv të agjencisë, i ka kaluar atij të gjithë pushtetin ekzekutiv, për të bërë një menaxhim sa më efikas të agjencisë dhe Drejtori është i detyruar të raportojë për administrimin e agjencisë në këtë keshill, në cdo mbledhje të Këshillit Ekzekutiv.

NENI 18

DREJTORI EKZEKUTIV

Drejtori ekzekutiv i agjencisë zgjidhet nga Këshilli i Ekzekutivit, me votë të fshehtë. Ai quhet i zgjedhur pasi ka marrë të paktën 2/3 e votave të anëtarëve të Këshillit të Ekzekutivit.

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë "AKDIE" është Z. Naim ALIAJ.

- Duke qene specialist per menaxhimin kolektiv,
- Për shkak të kontributit të dhënë në ndërtimin e Agjencisë "AKDIE",
- Për shkak të stabilitetit të përfaqësimit të Agjencisë me institucionet publike dhe me subjektet tatimpagues, përdorues të të drejtave të artistëve,
- Për shkak të përfaqësimit ligjor të Agjencisë "AKDIE" në Licensën e Administrimit Kolektiv, të dhënë nga organi kompetent,
- Për shkak të stabilitetit të marrëdhënieve ndërkombëtare me agjencinë "AKDIE"

Mandati i Drejtorit Ekzekutiv nuk është i kufizuar në kohë.

Drejtori ekzekutiv emëron dhe shkarkon personelin administrativ të Agjencisë. Këshilli Ekzekutiv, në marrëveshje me Drejtorin Ekzekutiv të Agjencisë përcakton pagesën e tij, e cila duhet të jetë në përputhje me pagën, nga ku vlerësohen detyrimet tatimore dhe sigurimet shoqërore për këtë lloj posti drejtues.

Drejtori Ekzekutiv është përfaqësuesi ligjor i Agjencisë AKDIE, në përgjithësi me të tretë, por për nivelet më të larta të përfaqësimit të institucioneve homologe dhe shtetërore, sipas raportit protokollar, zbatohet e drejta e përfaqësimit me të tretët nga Presidenti.

- 1.** Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë AKDIE, mund të largohet me dëshirën e tij nga detyra, sipas kërkesës së tij, të paraqitur në Këshillin Ekzekutiv dhe me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme, për këtë rast.
- 2.** Drejtori Ekzekutiv mund të shkarkohet vetëm nga Vendimi i Këshilli Ekzekutiv, me votim unanim të të gjithë anëtarëve të tij, duke i garantuar të drejtën e mbrojtjes së Drejtorit të Agjencisë, përpara Mbledhjes së Anëtarëve :

- Për shkelje të rëndë të Statutit.
- Për kryerjen e një krimi të rëndë penal.

Asambleja e Përgjithshme e Jashtëzakonshme, në një rast të tillë, drejtohet nga Presidenti i Nderit ose në mungesë të Presidentit të Nderit, nga anëtari më i vjetër i Agjencisë, i cili nuk është anëtar i Këshillit Ekzekutiv, i cili drejton këtë Mbledhje dhe Mbledhja e Artistëve themelues dhe Kontribues. Drejtuesi i kësaj Asambleje të Jashtëzakonshme, verifikon Vendimmarrjen unanime të Këshillit Ekzekutiv dhe vazhdon procedurën vetëm pasi verifikohet kjo vendimmarrje.

Asambleja e Përgjithshme e Artistëve, organizon dy seanca dëgjimore, brënda një afati të arsyeshëm, të miratuar nga kjo asamble, për të mbledhur provat e mjaftueshme.

- 1.** Në seancën e parë degjimore dëgjon secilin artist, anëtar të Këshillit Ekzekutiv dhe Drejtorin Ekzekutiv, pa praninë e secilit prej tyre
- 2.** Në seancën e dytë, i degjon artistët dhe Drejtorin Ekzekutiv, së bashku, në një seancë ballafaqese.

Në fund të seancës së dytë, Asambleja e Përgjithshme e anëtarëve themelues dhe kontribues, del me Vendim. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme, kundërshtohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas palëve të interesuara në rastin konflikt, nga Presidenti i Këshillit Ekzekutiv ose nga Drejtori Ekzekutiv, duke e deklaruar me turp, shkarkimin e tij nga detyra.

Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të Jashtëzakonshme, konsiderohet një Akt Administrativ, cili hyn në fuqi, vetëm pas kalimit të afatit 30 ditor të ankmimit gjyqësor.

Me ankimimin gjyqësor, Drejtori Ekzekutiv, qëndron në detyrë, deri sa vendimi gjyqësor të marrë formë të prerë.

NENI 19

KOMPETENCAT E DREJTORIT EKZEKUTIV

Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë "AKDIE", me zgjedhjen e tij në këtë post, nga Keshilli Ekzekutiv, ka te gjithë pushtetin ekzekutiv, për të zhvilluar një veprimtari në dobi të shoqërisë, duke marrë përsipër përgjegjësinë të sigurojë dhe të ndjekë ekzekutimin e Vendimeve të Këshillit Ekzekutiv dhe, nën drejtimin e kontrollin e këtij të fundit, të sigurojë në mënyrë të përgjithshme administrimin e Agjencisë, te cilen ai e drejton dhe e mbikqyr ne te gjitha shërbimet, si edhe ai është përfaqësues ligjor me të tretet, ku agjencia "AKDIE" futet në marrëdhënie kontraktuale, reciprociteti, probleme gjyqësore dhe problematika administrative.

Drejtori Ekzekutiv mban përgjegjësi penale, civile dhe administrative, në emër të agjencisë "AKDIE".

Drejtori Ekzekutiv ushtron këto kompetenca :

1. Ai përfaqëson ligjërisht Agjencinë "AKDIE" në cdo proces gjyqësor penal, civil, administrativ apo arbitrazhi.
2. Ai ndjek vetë ose vendosë përfaqësues ligjor, me anë të Autorizimit të tij, me vulën e Agjencisë "AKDIE", në cdo proces administrativ apo gjyqësor penal ose civil, për mbrojtjen e të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues, sipas këtij statuti dhe licensës së dhënë nga organi kompetent zyrtar, për veprimtarinë e saj specifike për administrimin kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues si dhe të ndjekë ekzekutimin e tyre, të arrijë marrëveshje jashtegjyqësore apo të heqe dore nga proceset administrative apo gjyqësore.
3. Ai mban shkrimet, llogaritë financiare dhe korrespondencën e Agjencisë.
4. Ai siguron arkëtimet dhe mbledhjen e te drejtave të administrueshme nga Agjencia "AKDIE".
5. Ai disponon llogarinë bankare dhe arkën e Agjencisë.
6. Ai siguron zbatimin e buxhetit dhe të shpenzimeve që rrjedhin nga nevoja e funksionimit të Agjencisë.
7. Ai përgatit tabelën e shpërndarjes së të ardhurave:
 - për çdo vepër artistike të përdorur,
 - për cdo artist kontribues në këtë vepër,
 - shpeshhtësinë e përdorimit të veprës,
 - koeficientin e shpërblimit të vlerave monetare totale/për minutazh vjetor përdorimi, sipas skemës vlera monetare të mbledhura në total nga përdoruesit Kryesor dhe nga përdoruesit Dytësor,
 - duke hequr paraprakisht, detyrimet detyrimet tatimore, komisionin statutor ose shpenzimet e domosdoshme të Agjencisë, sipas Buxhetit të miratuar.

dhe i'a paraqet Keshillit Ekzekutiv për aprovim.

8. Drejtori Ekzekutiv i Agjencisë është i detyruar të marrë pjesë në të gjitha Mbledhjet e Asambleve të Përgjithshme të Agjencisë dhe në Mbledhjet e Keshillit Ekzekutiv.

NENI 20

PËRFAQËSIMI LIGJOR;

Agjencia e Administrimit Kolektiv përfaqësohet ligjërisht nga Drejtori Ekzekutiv, përjashtuar rastet protokollare, ku përfaqësimi kryhet nga Presidenti ose Presidenti I Nderit.

Kapitulli III

FINANCAT E AGJENCISË

NENI 21

BURIMET FINANCIARE DHE KRITERET E PERDORIMIT TE TYRE

Burimet e të adhurave të Agjencisë "AKDIE" janë të ardhura nga :

- kuotizacioni, kur ka të tilla,
- vlera e kuotizacionit të një artisti, për agjencinë AKDIE është 2 500 në vit.
- fonde, grante dhe donacionet e afuara nga subjekte private dhe publike, vendas ose të huaja,
- si dhe të ardhurat nga komisioni statutor, i parashikuar në ligjin për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të.

Agjencia kryen shpenzime vetëm për realizimin e qëllimit dhe objektit të veprimtarisë, për të cilin është krijuar, si dhe për drejtimin dhe mirëmbajtjen e pasurisë së tyre.

Agjencia "AKDIE" ka të drejtën e marrjes hua financiare, sipas Vendimit të Këshillit Ekzekutiv dhe miratimit nga Asambleja e Përgjithshme e Artistëve themelues dhe kontribues, nga subjekte e përcaktuara në ligj dhe nga persona privat, **në cilësinë e investitorëve**, duke ruajtur gjithmonë interesin më të mirë të agjencisë, për një veprimtari sa më efikase, për të arritur qëllimin e saj.

NENI 21

RREGULLAT PËR BASHKIMIN DHE NDARJEN E ORGANIZATËS JOFITIMPRURËSE DHE RREGULLAT PËR LIKUIDIMIN DHE DESTINIMIN E PASURISË PAS MBARIMIT TË ORGANIZATËS.

Agjencia "AKDIE" ka të drejtë të transformohet ose të bashkohet me vendim të organit kompetent, sipas aktit të Asamblesë së Përgjithshme dhe konsiderohet e shpërndarë me regjistrimin e subjektit të ri.

Agjencia e Administrimit Kolektiv të Drejtës së Artistëve Interpretues dhe /ose Ekzekutues "AKDIE", si organizatë jo fitimprurëse, shpërndahet me inisiativën e saj ose me vendim gjykatë në rastet kur :

1. Veprimtaria e Agjencisë vjen në kundërshtim me Kushtetutën
2. Kur Agjencia kryen veprimtari të kundërligjshme
3. Kur Agjencia nuk është themeluar sipas kërkesave të ligjit
4. Kur Agjencia ka falimentuar sipas ligjit "Për falimentimin"

Neni 22

BUXHETIMI I AGJENCISË

1. Vlera statutorë për buxhetimin e Agjencisë „AKDIE“ nuk duhet të kalojë vlerën e 25 % të të ardhurave të mbledhura nga veprimtaria e administrimit kolektiv të të drejtave të artistëve interpretues/ekzekutues, për vitin kalendarik financiar, në 100 000 subjektet tatimpagues, përdorues të pronësisë artistike, sipas metodologjisë dhe/ose pritshmërisë tarifore të agjencisë.
2. Vlera 25% e të ardhurave të mbledhura është vlera e komisionit statutor për shpenzimet e agjencisë „AKDIE“, pasi janë hequr detyrimet që rrjedhin nga detyrimet ligjore tatimore, vendore dhe të tjera detyrime ligjore të pashmangshme, sipas legjislativës në fuqi dhe janë të drejtë specifike e Drejtorit Ekzekutiv të Agjencisë.
3. Marrë në konsideratë veprimtarinë e ndodhur, në rastin kur vlera e 25% të të ardhurave të mbledhura në total, nuk mjafton për të përballuar **shpenzimet e domosdoshme**, sipas zërave të kontrollit financiar tatimor, të paraqitur në Bilancin Vjetor, ku Agjencia „AKDIE“ deklaron si subjekt tatimpagues, pranë organit tatimor, si vijon :

1. Zëri i pagave të administratës

2. Zëri i qerasë së selisë
3. Zëri i energjisë elektrike, ujit, telefonisë, internetit
4. Zëri i kancelarisë-letër bojë printeri, rregullim kompiuterash, postës,
5. Zëri i shpenzimeve të domosdoshme gjyqësore
6. Zëri i shpenzimeve të domosdoshme të udhëtimit, dietave, naftës, qerasë së makinave, etj.
7. Zëri i komisioneve bankare
8. Zëri i shpenzimeve të panjohura

Në vlerën minimale prej 15 000 000 (pësemëdhjetë milion) lekë,

Këshilli Ekzekutiv, miraton rialokimin e fondeve të mbledhura, në drejtim të zërave të mësipërm, pas kontrollit financiar dhe miratimit të veprimtarisë financiare për vitin kalendarik, duke rritur përqindjen statutore.

Keshilli Ekzekutiv percakton me Vendim, i cili miratohet nga Asambleja e Përgjithshme e Artistëve themelues dhe kontribues, buxhetimin e agjencisë „AKDIE“, për cdo rast.

NENI 23

KONTROLLI I ADMINISTRIMIT FINANCIAR DHE EKONOMIK

1. Agjencia, informon sipas ligjit shqiptar ne fuqi, organet kompetente, per produktin financiar te mbledhur, kontratat me perdoruesit pronesise artistike, metodologjinë e monitorimit, të mbledhje/arkëtimit dhe shpërndarjes financiare,
2. Keshilli Ekzekutiv kontrollon administrimin financiar dhe ekonomik te agjensise.
3. Cdo artist, ka te drejte te marre informacion per administrimin financiar dhe ekonomik te agjensise sipas Statutit.
4. Veprimtaria financiare e AKDIE behet publike nepermjet faqes se saj ne internet.

NENI 24

E DREJTA PER ADMINISTRIMIN KOLEKTIV RECIPROK ME SHOQËRITË SIMOTRA NDËRKOMBËTARE

Agjencia e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Artistëve interpretues/ekzekutues "AKDIE" ka detyrimin e nënshkrimit të Kontratave të Përfaqësimit Reciprok, me agjencitë- Shoqëritë e Administrimit Kolektiv të të Drejtave të Artistëve, duke marrë përsipër të drejtat dhe detyrimet reciproke, sipas normave juridike ndërkombëtare, me qëllim ushtrimin dhe përfaqësimin e të drejtave të administrimit kolektiv, sipas të drejtave dhe territoreve përkatëse të veprimtarisë së secilës.

NENI 25

DETYRIMET E AGJENCISË "AKDIE" NDAJ ARTISTËVE

Në përputhje me Konventat dhe traktatet ndërkombëtare, "AKDIE" garanton të njëjtin trajtim ligjor, si për repertorin e huaj ashtu dhe atë vendas, si për artistin e huaj, ashtu edhe për artistin shqiptar.

Agjencia "AKDIE", arkëton pagesa për përdorimin masiv të të drejtave të artistëve, që kanë interpretuar/ekzekutuar në cdo vepër artistike, gjatë minutave të vitit kalendarik, sipas veprimtarisë së subjektit tatimpagues, sipas të drejtave të administrueshme nga Agjencia "AKDIE", pa dallim nacionaliteti, nënshkrimi statutor, pa paragjykim, pa asnjë stimulim.

Shpërndarja e shpërblimeve të mbledhura, pasi hiqen kostot ligjore tatimore dhe ato të komisionit të agjencisë për shpenzimet e domosdoshme, për arritjen e qëllimit të krijimit të saj, kryhet vetëm në bazë të shpeshtësisë së përdorimit të veprës, sipas minutazhit të veprës, e shumëzuar me koeficientin që del nga pagesë e arkëtuar me minutat e vitit kalendarik.

Vlera financiare e shpërblimeshme për veprën artistike, pjesëtohet me artistët kontribues të asaj vepre.

Pagesat për artistët shqiptarë, kryhet nëpërmjet **RAIFFEISEN BANK**, në numrat e llogarisë bankare, të cdo artisti, pavarësisht se është anëtarë statutor themelues apo kontribues, i Agjencisë AKDIE.

Pagesat për artistët e huaj, kryhen nëpërmjet **RAIFFEISEN BANK**, sipas saktësisë së Kontrollit Financiar të organizatave Ndërkombëtare AEPO-ARTIS dhe SCAPR, duke dërguar pagesat tek artistët, nëpërmjet Agjencisë së Administrimit Kolektiv, të territorit përkatës.

Për cdo veprim të mësipërm, Agjencia "AKDIE" informon organin e administratës publike, kompetent, për zbatimin e ligjit për të drejtën e autorit dhe të të drejtave të tjera të lidhura me të.

Për cdo dyshim të arsyeshëm, të kujtudo personi apo entiteti, agjencia informon dhe bashkëpunon ngushtë, me organet e specializuara të krimit ekonomik, pranë Drejtorisë së Policisë së Shtetit, Prokurorisë, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Shërbimit Informativ.

Agjencia "AKDIE" ka të drejtën e mbajtjes së komisionit statutor, për të mbuluar shpenzimet e domosdoshme, për një veprimtari efikase, por për cdo shpenzim të kryer ajo kontrollohet dhe është e drejta e Këshillit Ekzekutiv dhe e Asamblesë së Përgjithshme, për miratimin e këtyre shpenzimeve.

Agjencia "AKDIE", ushtron licensën, për administrim kolektiv të të drejtës së artistëve shqiptar dhe të huaj, në të gjithë Shqipërinë, për shkak se është e vetme në ushtrimin e kësaj të drejte, në territorin shqiptar dhe se nuk mund të dhe nuk duhet të ketë të dytë, si ajo në këtë veprimtari.

Arritja e qëllimeve të agjencisë "AKDIE", është në harmoni dhe përputhje me Vendimet e Asambleve të Përgjithshme të Artistëve themelues dhe kontribues, Kontratave të Përfaqësimit Reciprok dhe egjislacionit në fuqi (Konventa-traktate-marrëveshje ndërkombëtare-ligj organik).

Agjencia "AKDIE" udhëhiqet nga parimi i etikës, ku respektohet me përpikmëri detyrimi i Asamblesë së Përgjithshme të Artistëve themelues dhe kontribues, si dhe i Këshillit Ekzekutiv, në vendosjen e Drejtuesit Ekzekutiv, i cili nuk mund dhe nuk duhet të ketë konflikt interesi me qëllimet e agjencisë, duke u shmangur interesi i drejtëpërdrejtë apo i tërthortë apo të ketë pritshmëri nga shpërndarja e pagesave, nisur nga fakti se ai propozon listën e pagesës dhe kontrollon shpeshësinë e përdorimit të veprave artistike.

Agjencia AKDIE, u jep përdoruesve të veprave artistike, kundrejt një pagese a tarife, autorizimin për përdorimin e veprave, të interpretuara/ekzekutuara nga artistët;

Deklaron metodologjinë dhe pritshmërinë tarifore për përdorimin e veprave, të interpretuara/ekzekutuara nga artistët;

Perfaqëson interesat e artistëve, për shfrytëzimin e të drejtave, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke nënshkruar kontratat e reciprocitetit me agjenci të huaja të ngjashme;

Informon, sipas kërkesës së artistëve dhe të organeve kompetente, për mënyrën e administrimit të të drejtave, për raportin vjetor financiar dhe atë të kontrollit të të ardhurave financiare;

Siguron asistencë profesionale, për artistët, në mbështetje të dispozitave statutore,

Përfaqëson administrimin kolektiv të artistëve, gjatë procedurave ligjore;

Agjencia "AKDIE" u kërkon përdoruesve të dhënat dhe dokumentacionin e nevojshëm për përllogaritjen e pjesës së shpërblimeve që grumbullon ajo.

NENI 26

ADMINISTRATA E AGJENCISË

Agjencia "AKDIE" ka një administratë, e cila drejtohet nga Drejtori Ekzekutiv.

Administrata e AKDIE, rekrutohet nga ana e Drejtorit Ekzekutiv.

Çdo nëpunës i Agjencisë „AKDIE“, i nënshtrohet statutit, ligjit për organizatat jofitimprurëse dhe Kodit të Punës dhe Kontratave të Porosisë.

Drejtori Ekzekutiv, drejton Administratën e AKDIE, sipas Urdhërave, Udhëzimeve dhe Rregullores së Administratës.

Administrata e Agjencisë „AKDIE“, përbëhet nga Zyra Juridike, Zyra Për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Publikun dhe Institucionet Publike dhe Private, Zyra e Rregjistrimit të Repertorit të Artistëve, Zyra e Monitorimit në Terren, Zyra e Financës.

Nëpunësit e administratës janë Përgjegjës zyre dhe specialist.

Pagat e Administratës bazohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, përjashtuar drejtimin e Zyrës Juridike, e cila administrohet nga Zyrë Avokatie dhe Zyra e Financës, e cila administrohet nga Ekspert Kontabël i Autorizuar.

**ANËTARËT E
AGJENCISË AKDIE**